



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:143138

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06293086

KPPP.nr. 1633/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambienti” Sh.A., me numër unik identifikues 810538027 dhe seli në Pejë, rr. “Xhemë Sadrija”, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur sipas kërkesës së debitorit për kthim në gjendje të mëparshme e datës 19.07.2024, për shkak të humbjes së afatit për paraqitje të prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 826/20, i lejuar me datë 23.10.2020, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala me seli të zyrës në Pejë, jashtë seancës me datë 14.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e pasafatshme kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme, për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 826/20 i lejuar me datë 23.10.2020, nga Përmbartuesi Privat Zija Bala.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kreditorit me numër 26963, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 826/2020, të datës 23.10.2020, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej EUR 14,409.00, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e kalimi të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij urdhri, debitori me datë 05.04.2022, përmes postës rekomande me numër R 2301974, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor në tërësi me arsyetim se borxhi i akumuluar nuk është i këtu debitorit mirëpo i njëjti i takon Kuvendit Komunal të Pejës, dhe se debitori nuk ka pasur asnjë marrëveshje me kreditorin ashtu që borxhi i është faturuar debitorit në mënyrë të jashtëligjshme. Më tej, ka theksuar se përmbartuesi privat ka qenë i obliguar që të kërkoj dëshmi nga kreditori në mënyrë që t'i identifikoj palët përmbartimore e pastaj të ndërmerr veprime. Ndërsa, ka shtuar se borxhi i kërkuar nga kreditori është përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 360 të LMD-së. Në fund, ka theksuar se përmbartuesi privat është dashur që shkresat t'ia dorëzoj avokaturës shtetërore ngase sipas Ligjit nr. 04/L-157 për avokaturën shtetërore përcaktohet se ky institucion jep këshilla dhe mbron autoritet publike në procedurë gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurë administrative. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm ngase ka kaluar afati ligjor brenda të cilit debitori ka mundur të paraqes prapësim. Më tej, ka theksuar se janë të pabazuara pretendimet e debitorit se nuk ka ndonjë marrëveshje me kreditorin për shërbime të mbeturinave, ngase për shërbime të tilla të veçanta nuk është e nevojshme lidhja e marrëveshjes. Në fund, ka theksuar se faturimi për shërbimeve të mbeturinave i është bërë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe jo Komunës së Pejës, ndërsa gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin KPPP.1633/22, të datës 20.09.2023 e ka hedhur poshtë si të pasafatshme prapësimin e debitorit.

Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë, ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 1504/23, të datës 28.05.2024 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, ndërsa Aktvendimin e Dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate KPPP.nr. 1633/22, të datës 20.09.2023 e ka vërtetuar.

Tani, me datë 19.07.2024 debitori ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit. Në arsyetimin e kësaj kërkesë, debitori ka theksuar se organi përmbartimor ka bërë shkelje të legjislacionit në fuqi, pasi që urdhrin mbi lejimin e përmbartimit nuk e ka përcjellë tek përfaqësuesi ligjor i debitorit, edhe përkundër që me

dispozitat nga Ligjit për Avokaturën Shtetërore është përcaktuar se Avokatura shtetërore ka për obligim përfaqësimin ligjor dhe ruajtjen e pasurisë publike. Me tej, ka shtuar se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk paraqet provë të besueshme se Ministria e Punëve të Brendshme është debitore për borxhin e supozuar dhe se shërbimet komunale me të cilat është ngarkuar debitori janë parashkruar në kuptim të nenit 360 të LMD-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 826/20, të lejuar me datë 23.10.2020, është e pasafatshme për shkaqet si në vijim:

Gjykata gjen se përmbarruesi privat ka tentuar që t'ia dorëzoj debitorit urdhrin përmbarrimor P.nr. 826/20, të datës 23.10.2020, mirëpo që debitori me datë 05.11.2020 ka refuzuar ta pranoj shkresën e adresuar, fakt ky që vërtetohet nga konstatimi i zyrtarit të postës në flete kthesën për dorëzim personal e cila gjendet në shkresa të lëndës ku është konstatuar se *“Drejtori refuzon pranimin e shkresës: 05.11.2020”*.

Sipas nenit 18 të LPP-së, përcaktohet se *“Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të parapara për dërgimin e shkresave, vlejnë edhe për aktvendimin për përmbarrimin, urdhrin për përmbarrim, aktvendimin lidhur me prapësimin kundër aktvendimit për përmbarrim dhe aktvendimit për gjobën me të holla”*.

Ndërsa, me nenin 112 të Ligjit për procedurën kontestimore përcaktohet se: *“Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtar i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”*

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e cituara si më lartë, rezulton se Urdhri Përmbarrimor P.nr. 826/20, i lejuar me datë 23.10.2020, i është dorëzuar me datë 05.11.2020.

Ndërsa, me nenin 130, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i*

mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”, ndërsa me paragrafin 3 të po të njëjtit nen përcaktohet se “Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme”.

Prandaj, marrë parasysh faktin se dorëzimi i Urdhrit Përmbartimor P.nr. 826/20, i datës 23.10.2020 është konsideruar i rregullt datë 05.11.2020, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme debitorit e ka paraqitur me datë 19.07.2024, rezulton se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit gjashtëdhjetë (60) ditor brenda të cilit ka mundur të ushtrohet propozimi, dhe si rezultat i kësaj, duke u mbështetur edhe në nenin 17 të LPP-së lidhur me nenin 133 të Ligjit për procedurën kontestimore, i cili përcakton se “Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit”, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 70 të LPP-së, nenit 133, paragrafi 1 të LPK-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1633/22, datë 14.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.